

Raporti i Transparencës 2019
Deloitte Audit Albania Shpk

30 prill 2020

Audit & Assurance



Përmbajtja

Përmbajtja	1
Mesazhi i drejtimit- Deloitte Audit Albania Shpk	2
Rrjeti Deloitte	3
Çfarë sjell Deloitte Audit në tregjet e kapitalit	6
Monitorimi i cilësisë së auditimit të jashtëm dhe të brendshëm	10
Pavarësia, etika, dhe informacione të tjera shpjeguese	14
Anekse	18
Aneksi A Informacioni Financiar	19
Aneksi B Entitete të Interesit Publik	20



Mesazhi i drejtimit- Deloitte Audit Albania Shpk

Ky raport paraqet praktikat dhe proceset, të cilat aplikohen aktualisht nga Deloitte Audit Albania Shpk, në përputhje me nenin 45 të ligjit, nr. 10091, datë 5 Mars 2009 ndryshuar me ligjin nr. 47/2016, datë 28 Prill 2016 "PËR AUDITIMIN LIGJOR, ORGANIZIMIN E PROFESIONIT TË AUDITUESIT LIGJOR DHE TË KONTABILISTIT TË MIRATUAR".

Informacioni i përfshirë në këtë raport lidhet me situatën e Deloitte Audit Albania Shpk më 31 dhjetor 2019, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe.



Në Deloitte, ne jemi të angazhuar në kryerjen e vazhdueshme të auditimeve të cilësisë së lartë, përsosmërisë profesionale dhe shërbimit ndaj klientëve tanë, investitorëve dhe tregjeve të kapitalit. Ne kuptojmë se mjedisi ynë është duke ndryshuar vazhdimisht, duke rezultuar në rritjen e kompleksitetit, ndryshimeve teknologjike dhe pritshmërive më të larta të komunitetit dhe rregullatorëve. Ne i përgjigjemi këtyre ndryshimeve, duke ngritur standardet e cilësisë së auditimit nëpërmjet inovacionit dhe transformimit. Transformimi është një program i koordinuar në të gjithë rrjetin tonë global që do të na mundësojë të zgjerojmë aftësitë dhe vlerat që u ofrojmë klientëve. Një mundësi për të ofruar shërbime të vazhdueshme auditimit dhe dhënies së sigurisë me një cilësi të lartë, çdo herë, kudo. Në mënyrë që të nxisim përmirësime të vazhdueshme në cilësi, ne po transformojmë auditimin nëpërmjet përdorimit të mjeteve dhe teknologjive më innovative, siç janë teknikat e përparuara analitike, përfshirë zgjidhjet analitike Alchemy të zhvilluara lokalisht nga ne. Në të njëjtën kohë, po përmirësojmë programet tona të të mësuarit dhe zhvillimit për të siguruar aftësitë e kërkuara nga audituesi i gjeneratës së ardhshme, në një të ardhme të prirur drejt dixhitalizimit.

Investimi ynë në cilësinë e auditimit është fokusuar gjithashtu në sistemet dhe proceset tona për të monitoruar dhe matur performancën e auditimeve tona. Programi ynë për Monitorimin dhe Matjen e Cilësisë së Auditimit (MMCA) fokusohet në sigurimin e ekzekutimit të vazhdueshëm të auditimeve të cilësisë së lartë. Një element kyç i programit është përdorimi i teknologjisë për të rritur aftësinë e identifikimit të problematikave të cilësisë së auditimit gjatë kryerjes së auditimit më tepër sesa përmes rishikimeve të cilësisë pas auditimit.

Investimet tona në cilësi, inovacion dhe talent kanë një ndikim thelbësor në mënyrën se si ne i përmbushim përgjegjësitë tona të interesit publik dhe në krijimin e besimit me palët tona të interesit. Ky raport ju siguron një pasqyrë të Shoqërisë tonë dhe përcakton praktikat dhe proceset tona, duke shfaqur angazhimin dhe investimin tonë në cilësinë e auditimit.

Enida Cara FCCA, CA

Drejtoreshë e shërbimeve të Auditimit dhe Këshillimit të Sigurisë Financiare
Deloitte Audit Albania Shpk



Rrjeti Deloitte

Deloitte Audit Albania Shpk: struktura ligjore dhe pronësia

Deloitte Audit Albania Shpk është e lidhur me rrjetin Deloitte përmes Deloitte Central Europe Holdings Limited, një shoqëri anëtare e Deloitte Touche Tohmatsu Limited. Deloitte Audit Albania Shpk referohet gjatë këtij raporti si "Deloitte Audit Albania", dhe Deloitte Central Europe Holdings Limited i referohet gjatë këtij raporti si "Deloitte Europa Qëndrore". Deloitte Europa Qëndrore është një organizatë rajonale e shoqërive të organizuara nën emrin Deloitte Central Europe Holdings Limited. Shërbimet sigurohen nga filialet dhe degët e Deloitte Europa Qëndrore Holdings Limited, të cilat janë shoqëri të veçanta dhe të pavarura. Deloitte Central Europe Holdings Limited mban të drejta praktike për të ofruar shërbime profesionale duke përdorur emrin

"Deloitte", emër i cili shtrihet tek shtetet që permban Deloitte Central Europe (i përbërë nga Shqipëria), përfshirë Deloitte Albania.

Deloitte Albania është e autorizuar të shërbejë si auditues për klientët në Shqipëri.

Deloitte Audit Albania operon si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, themeluar sipas ligjit Shqiptar, me zyrë të regjistruar në Rr. "Faik Konica", 1010, Tiranë, Shqipëri dhe numër regjistrimi L41709002H.

Mbajtësit e kuotave janë si më poshtë:

- Olindo Shehu - 51 %
- Deloitte Central Europe Holdings Limited - 49 %

Kërkesa për licencim për pajtueshmërinë me ligjin

Deloitte Audit Albania është regjistruar në regjistrin publik të ekspertëve kontabël të autorizuar pranë Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) më 31 korrik 2014 me numër license 423.

Përshkrimi i rrjetit

Rrjeti Deloitte

Rrjeti Deloitte është një rrjet global shoqërisht anëtare dhe filialeve të tyre që operojnë në më shumë se 150 shtete dhe territore në të gjithë botën. Këto shoqëri të vecanta dhe të pavarura operojnë nën një markë të përbashkët.



Deloitte Touche Tohmatsu Limited (DTTL ose Deloitte Global)

Deloitte Touche Tohmatsu Limited është një Shoqëri e themeluar në Mbretërinë e Bashkuar, me përgjegjësi të kufizuar me garanci. DTTL kryen një rol koordinues për shoqëritë anëtare dhe filialet e tyre duke kërkuar respektimin e politikave dhe protokolleve me qëllim të promovimit të një niveli të vazhdueshëm të lartë të cilësisë, sjelljes profesionale dhe shërbimit në të gjithë rrjetin Deloitte. DTTL nuk ofron shërbime profesionale për klientët dhe as nuk drejton, menaxhon, kontrollon ose zotëron ndonjë interes në asnjë shoqëri anëtare apo filial të tyre.

Për më shumë informacion rreth rrjetit Deloitte, ju lutemi shihni: [Rreth Deloitte](#)



Deloitte Audit Albania: qeverisja – bordi drejtues

Deloitte Audit Albania operon si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, themeluar sipas ligjit Shqiptar, me zyrë të regjistruar në Rr. "Faik Konica", 1010, Tiranë, Shqipëri dhe numër regjistrimi L41709002H

Bordi i Drejtuesve të Deloitte Audit Albania është përgjegjës për qeverisjen dhe mbikëqyrjen e praktikës së Auditimit dhe Sigurisë. Përgjegjësitë specifike përfshijnë aprovimin e strategjisë lokale të biznesit për auditimin dhe sigurinë, aprovimin e aspekteve financiare të planeve të biznesit vendor. Bordi i Drejtuesve asistohet nga ekipe të specializuara që këshillojnë për çështje specifike dhe / ose zbatojnë politika.

Më poshtë paraqiten anëtarët e Bordit Drejtues të Deloitte Audit Albania, të emëruar nga mbledhja e aksionerëve dhe nga Audituesit Ligjor të Autorizuar prej katër vitesh që nga data e emërimit:

Deloitte Audit Albania – Bordi i Drejtuesve

Olindo Shehu – Administrator

Enida Cara – Administratore

Gregory Paul Rossouw - Administrator

Partnerët dhe Drejtuesit e mësipërm veprojnë si administratorë të Deloitte Audit Albania, në përputhje me statutin e shoqërisë sipas ligjit nr. 9901 datë 14 Prill 2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Deloitte Audit Albania më 31 dhjetor 2019 ka të punësuar 39 punonjës profesionistë.

Në të gjitha aktivitetet e tyre, drejtuesit e lartë të Deloitte Audit Albania janë përgjegjës kryesor të cilësisë së auditimit, duke përfshirë pajtueshmërinë me standardet profesionale të zbatueshme dhe kërkesat rregullatore. Strategjia e Deloitte Audit Albania është zhvilluar në përputhje me orientimin e përgjithshëm strategjik të krijuar për rrjetin Deloitte.

Qëllimi dhe angazhimi ynë: të nxitim besim dhe konfidencë

Në Deloitte Audit Albania, qëllimi ynë është të bëjmë një ndikim që ka rëndësi. Për Auditimin dhe Sigurinë, kjo nënkupton përqendrimin në dhënien e auditimeve të pavarura me cilësi të lartë dhe nxitjen e konfidencës dhe besimit në tregjet e kapitalit përmes raporteve tona. Kjo kërkon që ne të ndërtojmë vazhdimisht aftësi për të mbështetur kryerjen e auditimeve me cilësi të lartë dhe të japim kontribute kryesore në formimin e së ardhmes së profesionit të auditimit.





Çfarë sjell Deloitte Audit në tregjet e kapitalit

Transformimi i Auditimit dhe Sigurisë

Të qenit një profesion i përshtatshëm i së ardhmes dhe të ruajturit të një praktike të qëndrueshme që zhvillohet me ritmin e ndryshimit në teknologji dhe shoqëri është mjaft kritike. Iniciativa e Transformimit të Deloitte Audit dhe Siguri, ka pikërisht këtë qëllim, që aktualisht po zhvillohet dhe është vendosur nga Deloitte Audit Albania nën përgjegjësinë e vetme të Deloitte Audit Albania.

Transformimi i Auditimit dhe Sigurisë është një ndryshim i rëndësishëm në të gjithë rrjetin në mënyrën si punojnë profesionistët e Deloitte dhe përfshin:

Mënyra Deloitte: standartizimi i proceseve të auditimit të mbështetura nga përshtatja teknologjike	Monitorim i cilësisë të auditimit në kohë reale
Fuqizimi i modelit të talentuar, që përfshin të mësuarit, shpërblimet, qendrat e përsosmërisë dhe qendrat e shpërndarjes	Implementimi i shpejt i mjeteve dhe teknologjive për t'iu përgjigjur ndryshimeve rrethore

Pranimi dhe vazhdimi i angazhimit të auditimit

Deloitte Audit Albania ka politika dhe procedura të detajuara për pranimin e klientëve dhe angazhimeve të ardhshme dhe vlerësimin e rrezikut të angazhimit. Këto politika dhe procedura janë hartuar me objektivin që Deloitte Audit Albania pranon vetëm angazhimet ku:

- Është në gjendje të kryejë angazhimin dhe ka aftësi, duke përfshirë kohën dhe burimet, për ta bërë këtë.
- Mund të pajtohet me të gjitha kërkesat përkatëse etike dhe standardet profesionale, duke përfshirë vlerësimet dhe konsideratat e pavarësisë dhe të konflikteve të interesit.
- Ka konsideruar integritetin e ekipit të menaxhimit të klientit potencial.

Iniciativat për mësim dhe zhvillim

Qendra për iniciativën e transformimit të Auditimit dhe Sigurisë janë përmirësime të ndryshme të modelit të talentit Deloitte:

Qasja e shndërruar e Deloitte ndaj ofrimit të auditimit po u mundëson profesionistëve tanë të përdorin analiza më të avancuara, të aplikojnë mjetet më të fundit, teknologjitë dhe të menduarit më kritik, të shpenzojnë më shumë kohë duke aplikuar gjykimin profesional dhe të fitojnë një kuptim më të thellë të biznesit dhe industrisë së një klienti - të gjitha kontribuojnë për të përmirësuar cilësinë e auditimit dhe një përvojë e përmirësuar për njerëzit tanë.

Deloitte ka bërë investime thelbësore në talentin tonë dhe strategjitë e të mësuarit dhe ka transformuar kurrikulën tonë të auditimit teknik për të ndërtuar aftësitë e kërkuara nga niveli:

- Në thelb, ne kemi një kurrikul të vetëm të detyrueshëm të mësimit teknik të Auditit, duke targetuar nxënësit sipas nivelit, duke përdorur një përzierje dinamike të kurseve të drejtuara nga instruktorët drejtpërsëdrejti dhe në mënyrë dixhitale sipas kërkesave dhe aktiviteteteve në punë.
- Të gjithë profesionistët e shërbimit të klientëve u kërkohet të kryejnë të paktën 20 orë arsimim të vazhdueshëm profesional (CPE) çdo vit dhe të paktën 120 orë çdo tre vjet, përmes programeve të strukturuar, të të mësuarit, të tilla si kurse të brendshme ose të jashtme, seminare ose mësim elektronik që mbulon të gjitha fushat e modelit të kompetencave (p.sh., kompetencat e përbashkëta, kompetencat teknike specifike të funksionit dhe kompetencat në fushat e specializimit).

Deloitte ka krijuar gjithashtu mundësi specifike të të mësuarit për specialistët që punojnë në angazhimet e auditimit për të mbështetur njohuritë e tyre dhe të kuptuarit e procesit të auditimit. Menaxhimi i zgjeruar i projektit, aftësia kryesore për ekzekutimin e angazhimeve të auditimit, është përfshirë në programet vjetore të zhvillimit.

Qëllimi i programit të zhvillimit profesional të Deloitte Audit Albania është të ndihmojë partnerët dhe profesionistët e tjerë të mbajnë dhe të rrisin kompetencën e tyre profesionale dhe të sigurojnë konsistencën e kryerjes të auditimit. Për të mundësuar zhvillimin në vendin e punës, Deloitte Audit Albania ofron programe zyrtare të zhvillimit të vazhdueshëm profesional në lëndë të fushave relevante që konsistojnë me Deloitte Audit Albania Audit Curriculum.

Gjatë viteve të para, shumica e trajnimeve përbëhen nga kurse të detyrueshme për tema teknike, duke përfshirë metodologjitë dhe proceset e auditimit, por më pas rritet pjesa opsionale, duke pasur parasysh se nevojat individuale bëhen më të larmishme.

Nga një periudhë përafërsisht katër vjecare, një program mesimor individual kërkohet.

Nëpërmjet një sistemi të automatizuar të monitorimit është e mundur të kontrollohet gjendja e kurseve të brendshme dhe të jashtme të ndjekura nga një auditues.

Edukimi i vazhdueshëm është gjithashtu një faktor i marrë në konsideratë për vlerësimin vjetor të stafit të auditimit dhe vlerësimin e potencialit të tyre të rritjes profesionale.

Deloitte Audit Albania përcakton nivelet minimale të zhvillimit të vazhdueshëm profesional që duhet të ndërmerren nga partnerët dhe profesionistët e tjerë brenda një periudhe të caktuar kohore. Për të arritur këto nivele të zhvillimit, Deloitte Audit Albania ofron programe të strukturuar formale të të mësuarit, të tilla si kurse të brendshme ose të jashtme, seminare, ose trajnime online që mbulojnë të gjitha fushat e modelit të kompetencës (p.sh., kompetencat e përbashkëta, kompetencat teknike specifike të funksionit dhe kompetencat në fushat e specializimit).

Universiteti Deloitte

Deloitte kultivon në mënyrë aktive njohuritë dhe aftësitë e veta kolektive të profesionistëve globalisht përmes vazhdimit të investimeve në Universitetet Deloitte (DU). Këto janë qendra më të mira të mësimit dhe zhvillimit të përqendruara në kulturën Deloitte, dhe të rrënjosura në parimet e lidhjes dhe udhëheqjes në një mjedis mësimi shumë gjithëpërfshirës¹.

Deloitte.
University

Kompensimi i Partnerit

Kryerja e auditimeve të cilësisë së lartë pritet nga të gjithë profesionistët e Deloitte dhe është ezbatueshme në të gjithë rrjetin e tij. Cilësia e auditimit është ndërtuar në standarde të performancës në çdo nivel, kundrejt të cilave maten vlerësimet e përgjithshme të profesionistëve.

Partnerët e Deloitte Audit Albania vlerësohen çdo vit, dhe në varësi të rezultatit të vlerësimit, shpërblimi i partnerëve mund të rritet ose të ulet. Në mënyrë të veçantë, vlerësimet e partnerëve marrin parasysh faktorët e mëposhtëm: cilësinë, ekspertizën, integritetin, profesionalizmin, sipërmarrjen, pavarësinë dhe pajtueshmërinë.

Auditimet me cilësi të lartë që ne ofrojmë

Përvoja e një kontrolli të një cilësie të lartë, e realizuar mirë, do t'i sigurojë komiteteve të auditimit, investitorëve dhe palëve të tjera të interesit të kompanive (por pa u kufizuar në to):

- Një raport auditimi që është i përshtatshëm për rrethanat.
- Inovacioni në atë se si ne e bëjmë auditimin.
- Më shumë njohuri mbi kompaninë e tyre sesa ata kishin në fillim të procesit.





Monitorimi i cilësisë së auditimit të jashtëm dhe të brendshëm

Matja dhe Monitorimi i Cilësisë së Auditimit

Një fokus i vazhdueshëm në cilësinë e auditimit është me rëndësi kyçe për markën Deloitte. Është e rëndësishme që një auditim i kryer nga Deloitte të jetë me cilësi të lartë, kurdo dhe kudo që të kryhet në botë.

Objektivat e programit të Monitorimit dhe Matjes së Cilësisë së Auditimit (MMCA) janë:

- Transformimi i mënyrës se si monitorohet dhe matet cilësia e auditimit dhe si zgjidhen mangësitë e auditimit; dhe
- Ngritja e sistemit të brendshëm të kontrollit të cilësisë që ndjekin të gjitha shoqëritë e rrjetit Deloitte

Programi MMCA është i fokusuar në nxitjen për:

- Monitorim të vazhdueshëm, konsistent dhe të fuqishëm të angazhimeve të kryera dhe në zhvillim.
- Të kuptuarit të mangësive kryesore dhe ekzekutimit në kohë të veprimeve korrigjuese nga të gjitha shoqëritë anëtare në mënyrë të vazhdueshme.
- Transparencë dhe konsistencë më të lartë në raportimin e masave kyçe të cilësisë së auditimit

Deloitte Audit Albania ndjek politika dhe procedura për të promovuar një kulturë të brendshme bazuar në njohjen e faktit se cilësia është prioriteti numër një. Deloitte Audit Albania fokusohet në përsosmërinë profesionale si bazë për arritjen e cilësisë së auditimit në mënyrë të vazhdueshme.

Modeli multidisiplinar

Auditimi është themeli i markës Deloitte. Përveç Auditimit dhe Sigurimit, Deloitte Audit Albania ka praktikën e konsultimit, këshillimit financiar, këshillimit të rreziqeve, dhe taksave dhe ligjit. Diversiteti i pesë bizneseve të ndryshme nën një ombrellë (modeli multidisiplinar) është një nga diferencuesit kryesorë të auditimeve me cilësi të lartë.


Ndër përfitimet e modelit multidisiplinar për auditim:

- Është e mundur të zhvillohen njohuri të industrisë përmes lenteve të shumta, gjë që rrit kuptueshmërinë e auditorëve për rreziqet e biznesit të rëndësishme për kryerjen e auditimeve.
- Praktika e auditimit ka qasje të menjëhershme në burime të specializuara dhe ekspertizë në linja të tjera biznesi. Ai promovon cilësinë e auditimit sepse auditorët mund të përdorin ekspertizën e profesionistëve këshillëdhënës të cilët janë të aftë në lëndë që shpesh nuk janë autoktone për auditorët.
- Një organizatë e larmishme ndihmon në tërheqjen dhe ruajtjen e talentit paresor.
- Kapitali intelektual është i disponueshëm brënda rrjetit për të zhvilluar proceset e auditimit, teknologjitë, etj.

Ngjarjet me cilësi negative kanë potencialin të ndikojnë në markën Deloitte në tërësi. Si i tillë, çdo biznes jo-auditues i Deloitte ka një interes të përbashkët dhe të dhënë për të mbështetur nismat e cilësisë së auditimit.



Monitorimi dhe Matja e Cilësisë së Auditimit



Monitorimi në proces "in-flight"

Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së auditimit nga Deloitte Audit Albania jep një përgjigje më të shpejtë për çështjet e auditimit mbi angazhimet në proces "in-flight", identifikimin e duhur, zgjidhjet në kohë dhe veprimet korigjuese në kohë reale të arritura nga:

- Vendosjen dhe monitorimin e një sërë diagnozash thelbësore, duke mundësuar që partnerët dhe ekipet e angazhimit, të monitorojnë vazhdimisht cilësinë e auditimit dhe për të ndërmarrë veprime të menjëhershme.
- Një program specifik "health check" për të ndihmuar drejtuesit e cilësisë së auditimit të Deloitte Audit Albania në vlerësimin e progresit dhe identifikimin e çështjeve të mundshme në angazhimet në proces "in-flight".

Shqyrtime të Angazhimit

Komponentët kryesorë të shqyrtimeve të angazhimit (shqyrtimet e praktikave të brendshme) përfshijnë:

- Përzgjedhja e angazhimit të bazuar në rrezik dhe shqyrtimi i të gjitha industrive kryesore të shërbyera nga Deloitte Audit Albania.
- Paneli i detyrueshëm i moderimit për të ngritur qëndrueshmërinë në gjetjet dhe vlerësimet e angazhimit.
- Partnerët e jashtëm dhe përfaqësuesit që mbikëqyrin praktikën e rishikimeve për të rritur qëndrueshmërinë.
- Identifikimi i burimeve të përshtatshme (nga Deloitte Europa Qëndrore si dhe nga gjeografite e tjera Deloitte) me eksperiencën e duhur dhe ekspertizën e industrisë, duke përfshirë krijimin e ekipeve qendrore të shqyrtimit.

Sistemi i kontrollit të cilësisë (SKC)

SKC përfshin elemente të shumta të tilla si dokumentimi i fushave kryesore të proceseve të SKC dhe kontrolleve, si dhe kryerja e procedurave për testimin e efektivitetit operativ të SKC, duke përfshirë ekzekutimin e një programi të plotë të shqyrtimit të SKC.

Treguesit e Cilësisë së Auditimit (AQIs) ndihmojnë më tej Deloitte Audit Albania në zhvillimin dhe monitorimin e planeve të veprimit dhe raportimin mbi progresin e cilësisë së auditimit gjatë procesit të auditimit. AQIs janë të integruar me aktivitetet e vazhdueshme nga programi i monitorimit të cilësisë së auditimit (AQMM).

Përveç kësaj, koha dhe sekuenca e duhur e aktiviteteve të auditimit, duke përfshirë rishikimet në kohë të punës së kryer dhe zgjidhjen e çështjeve të identifikuara, janë të lidhura ngushtë me kryerjen e auditimeve me cilësi të lartë. Cilësitë kryesore të auditimit kanë për qëllim të nxisin qëndrueshmërinë e ekipeve të angazhimit në menaxhimin e projekteve, kohën kur bëhet puna dhe fokusimin e nevojshëm në personelin e angazhimit, duke përfshirë mjaftueshmërinë dhe ekspertizën e burimeve të caktuara.

Analiza faktike dhe rehabilitimi i faktorit

Përqendrimi në përmirësimin e vazhdueshëm është thelbësor për nxitjen e përmirësimeve në cilësinë e auditimit. Identifikimi i mangësive që ndodhin gjatë auditimit është thelbësor për hartimin e planit efektiv për të adresuar gjetjet. Plani i Cilësisë së Auditimit është përgatitur nga Deloitte Audit Albania dhe siguron zbatimin efektiv dhe monitorimin e prioritetëve kryesorë të cilësisë së auditimit.

Inspektimet e jashtme

Përveç kontrollit të brendshëm të cilësisë së auditimit Deloitte Audit Albania, i nënshtrohet kontrolleve të jashtme nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë (IEKA) dhe Bordit Publik të Mbikëqyrjes. Kontrolli i fundit i sigurimit të cilësisë u krye më 22 Nëntor 2018 nga Bordi Publik i Mbikëqyrjes së Shqipërisë.

Deklaratë mbi efektivitetin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë

Ne konfirmojmë se jemi të kënaqur që kontrollet dhe sistemet tona të brendshme të kontrollit të cilësisë janë të fuqishme, funksionojnë në mënyrë efektive dhe na lejojnë të identifikojmë me lehtësi çdo fushë potenciale zgjerimi. Ne vazhdimisht kërkojmë të përmirësojmë të gjitha aspektet e biznesit tonë, duke përdorur gjetjet që vijnë si rezultat i rishikimit të praktikës, rishikimeve të tjera të brendshme dhe rishikimeve të jashtme rregullative për të forcuar sistemin tonë të kontrollit të cilësisë.

Aftësitë organizative që ne ndërtojmë

Kultura e Deloitte dhe hartimi i programeve tona të të mësuarit i vendosin njerëzit tanë në radhë të parë. Profesionistët e Deloitte janë teknikisht të aftë me nivele të larta etike, integriteti, skepticizëm profesional dhe objektivitet, dhe përmirësohen vazhdimisht.

Deloitte është e përkushtuar të zhvillojë njerëzit e saj dhe të përshpejtojë karrierën e tyre duke krijuar një mjedis mësimi gjatë gjithë jetës. Ne po avancojmë arsimin e auditimit, aftësitë dhe opsionet fleksibël të karrierës që apelojnë për auditorët e ardhshëm.

Për më tepër, disiplinimi operacional, administrimi efektiv i biznesit tonë dhe zhvillimi i një qasjeje të veçantë për të bërë auditime të njohura si Mënyra e Deloitte, ofrojnë bazën për angazhimin tonë për të sjellë qëndrueshmëri në auditimet tona.

Ne po drejtojmë një biznes të qëndrueshëm të auditimit dhe sigurimit që dëmshpërblen njerëzit e tij në mënyrë të drejtë dhe financon investime të vazhdueshme në biznesin tonë.





Pavarësia, etika, dhe informacione të tjera shpjeguese

Pavarësia e Deloitte Audit Albania Shpk



Përcakton **politikat dhe procedurat e pavarësisë** të bazuara në Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë të lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët dhe, Kryen shqyrtime të plota të kontrolleve të cilësisë së pavarësisë në një cikël trevjeçar; shqyrtimet e fokusuara vjetore për vitet jashtë ciklit; dhe shqyrtime të hollësishme pasuese sipas nevojës.



Kryen **aktivitete të vazhdueshme monitoruese**, duke mundësuar zgjerime të vazhdueshme të politikave, kontrolleve të cilësisë, mjeteve dhe aktiviteteve mbështetëse të praktikave.



Përdor **sistemet e informacionit dhe bazat e të dhënave** për tu siguruar profesionistëve informacionin e brendshëm të njësisë për të mbështetur pajtueshmërinë me kërkesat personale dhe profesionale të pavarësisë, duke përfshirë interesat financiare dhe qëllimin e aprovimit të shërbimit.



Mbështet **ndërgjegjësimin mbi pavarësinë** përmes komunikimeve periodike dhe njoftimeve, si dhe zhvillimin e udhëzimeve, mësimëve dhe instruksioneve.

Pavarësia e Deloitte Audit Albania

Deloitte Audit Albania ka politika dhe procedura të përcaktuara për të pasur pajtueshmërinë me standardet e aplikueshme profesionale që lidhen me pavarësinë. Këto politika dhe procedura bazohen në Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë të lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët dhe plotësohen sipas nevojës për të reflektuar kërkesat shtesë kombëtare ose rajonale që mund të jenë më kufizuese se kodi. Drejtimi i Deloitte Audit Albania përforcon rëndësinë e pajtueshmërisë me standardet e pavarësisë dhe standardet e lidhura me kontrollin e cilësisë, duke vendosur kështu theksin e duhur në krye dhe duke futur rëndësinë e tij në vlerat dhe kulturën profesionale të Deloitte Audit Albania. Strategjitë dhe procedurat për të komunikuar rëndësinë e pavarësisë për partnerët, profesionistët e tjerë dhe stafin mbështetës janë miratuar duke theksuar përgjegjësinë e çdo individi për të kuptuar dhe përmbushur kërkesat e pavarësisë.

Elementet kryesore të sistemit të kontrollit të cilësisë që Deloitte Audit Albania implementon në përputhje me politikat e tij përfshijnë:

- Pranimi dhe monitroimi i angazhimit
- Monitorimi i kërkesave për rotacion
- Vlerësimi dhe monitorimi i marrëdhënieve të biznesit
- Përdorimi i mjeteve të biznesit mbi procesin e pavarësisë, duke përfshirë sistemin të kërkimit dhe pajtueshmërisë Deloitte (DESC), Sistemin Global të Monitorimit të Pavarësisë (GIMS), konfirmimet vjetore të pavarësisë, dhe procedurat e konsulencës, për të monitoruar pajtueshmërinë me kërkesat e pavarësisë.
- Procedurat për të identifikuar dhe analizuar mosrespektimin e kërkesave të pavarësisë dhe aplikimin e masave dhe veprimeve disiplinore përkatëse
- Të mësuarit dhe komunikimet lidhur me pavarësinë
- Caktimi i përgjegjësisë për sistemet dhe kontrollet e pavarësisë
- Një rishikim i brendshëm mbi pajtueshmërinë e pavarësisë u krye gjatë këtij viti dhe raporti u lëshua më 29 nëntor 2019

Rotacioni i partnerëve dhe profesionistëve kryesorë të auditimit

Deloitte Audit Albania ka politika dhe procedura që kërkojnë rotacionin e partnerëve kryesorë të auditimit siç përcaktohet në nenin 42 të ligjit nr. 10091, datë 5 mars 2009 i ndryshuar me ligjin nr. 47/2016, datë 28 prill 2016 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar". Individët përgjegjës për kryerjen e një auditimi ligjor nuk duhet t'i shërbejnë angazhimit të audituar për më shumë se shtatë vite rresht në pozitën e një partneri kryesor të auditimit. Ata nuk duhet të marrin pjesë sërish në auditimin ligjor të subjektit të audituar para se të ketë kaluar një periudhë dy vjeçare pas ndërprerjes së këtij shërbimi. Gjatë kësaj periudhe dy vjeçare, partneri kryesor i auditimit nuk duhet të marrë pjesë në auditimin e subjektit të audituar, të kryejë rishikimin e kontrollit të cilësisë të angazhimit, të konsultohet me ekipin e angazhimit ose subjektin e audituar në lidhje me çështjet teknike ose specifike të industrisë, ose ngjarjet, pasi ndikojnë drejtpërsëdrejti në rezultatin e auditimit ligjor.

Ndërkaq është përgjegjësi parësore e individëve që shërbejnë si partnerë kryesorë të auditimit për të siguruar që ata janë në përputhje me kërkesat e rotacionit, Deloitte Audit Albania zbaton një proces monitorimi që përfshin, ndër të tjera, analiza të portofolit të klientëve dhe individëve të caktuar në role të ndryshme të auditimeve ligjore, duke konsideruar kompetencat, aftësitë, ngarkesën e punës dhe disponueshmërinë e audituesve ligjorë në mënyrë që t'u mundësojë këtyre individëve që të përmbushin në mënyrë adekuate përgjegjësitë e tyre si partnerë kryesorë të auditimit.


Etika e Deloitte Audit Albania

Deloitte Audit Albania mban politika dhe procedura të krijuara për të siguruar një siguri të arsyeshme që profesionistët e saj përputhen me kërkesat përkatëse etike.

Kërkesat etike për auditimin dhe shërbimet e lidhura me sigurimin e ofruara nga Deloitte Audit Albania janë në përputhje me kërkesat e IEKA. Deloitte Audit Albania gjithashtu përputhet me kërkesat dhe udhëzimet e përcaktuara në Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Kontabilistët Profesionistë ("Kodi") të lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët, një organ përcaktues standard i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC). Kur kërkesat profesionale kombëtare janë më kufizuese sesa politikat dhe procedurat e Kodit, Deloitte Audit Albania ndjek kërkesat e zbatueshme kombëtare.

Deloitte Audit Albania ka emëruar një Zyrtar të Etikës, i cili është një partner me përvojë, me qasje të drejtpërdrejtë te CEO dhe organi drejtues i firmës anëtare. Për më tepër, Deloitte Audit Albania ka zhvilluar dhe implementuar kodin e tij të sjelljes, i cili përshkruan sjelljet kritike profesionale që pasqyrojnë zakonet, rregulloret dhe kërkesat ligjore të vendit.

Deloitte Audit Albania ofron kanale komunikimi përmes të cilave partnerët, profesionistët e tjerë dhe personeli ndihmës mund të konsultohen dhe raportojnë çështje dhe situata etike. Deloitte Audit Albania forcon angazhimin e tij për etikën dhe integritetin përmes mjeteve të komunikimit, programeve të mësimin, proceseve të përputhjes dhe sistemeve të vlerësimit. Për më tepër, Deloitte Audit Albania kërkon që të gjithë partnerët, profesionistët e tjerë dhe personeli mbështetës të konfirmojnë çdo vit që ata kanë lexuar dhe kuptuar kodin e sjelljes dhe të kuptojnë se është përgjegjësia e tyre që të zbatojnë atë.



Formimi i së ardhmes së profesionit të auditimit

Ekipet e menaxhimit, komitetet e auditimit, investitorët, rregullatorët dhe përcaktuesit standardë të gjithë luajnë role thelbësore në formimin e mjedisit në të cilin kryhen auditimet. Ne përpiqemi të angazhohemi me këto palë, zyrtarisht dhe joformale, për të shkëmbyer, ofruar dhe debatuar idetë me qëllim të sigurimit të rëndësisë së auditimit dhe sigurimit në tregjet e kapitalit.



Anekse



Aneksi A | Informacioni Financiar

Shënime shpjeguese në përputhje me nenin 45 të ligjit nr. 10091, datë 5 mars 2009 i ndryshuar me ligjin nr. 47/2016, datë 28 prill 2016 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar".

Ndarja e të ardhurave vjetore të Deloitte Audit Albania për 2019:

Të ardhurat	LEK
Auditimi Ligjor (EIP ose filiale të EIP)	55,959,647
Auditimi Ligjor (jo-EIP ose filiale të jo-EIP)	16,235,646
Shërbime jo-auditimi (entitete të tjera)	6,526,872
Shërbime të tjera të këshillimit dhe sigurisë financiare	25,668,492
Totali	104,390,657



Aneksi B | Entitete të Interesit Publik

Shënime shpjeguese në përputhje me nenin 45 të ligjit nr. 10091, datë 5 mars 2009 i ndryshuar me ligjin nr. 47/2016, datë 28 prill 2016 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar" dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 17, datë 16.01.2019, datë 18 Janar 2019, që përcakton se cilat kompani do të konsiderohen me "interes publik" për sa i përket natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të të punësuarve..

Entitetet e Interesit Publik të Audituarra për Qëllime Ligjore nga Deloitte Audit Albania në vitin financiar 2019:

Emri

OTP Bank Albania SH.A

Alpha Bank SH.A

Agjensia Sigurimit Depozitave

Telekom Albania SH.A

Devoll Hydropower SH.A

Tete Albania Tunnel & Mining SH.A

Albanian Marketing Service SH.P.K

Rossmann & Lala SH.P.K

Procredit Bank Albania SH.A

Colacem Albania SH.P.K

ITX Albania SH.P.K

Huawei Technologies (Albania) SH.P.K

Rogner Hotel Tirana SH.P.K

GEN-I Tirana SH.P.K

British American Tobacco Albania SH.P.K

Comdata Albania SH.P.K

Rural Credit Guarantee Foundation

PARR SH.P.K

Technip Italy S.P.A - Tirana Branch

Facile.it - Broker di Assicurazioni S.r.l Albania Branch

Kryqi Kuq Shqiptar

Subjektet e interesit publik për të cilat janë siguruar shërbime të tjera të sigurimit në vitin financiar 2019:

Name

Balfin Group

Deloitte.

Deloitte i referohet një ose më shumë shoqërive anëtare të Deloitte Touche Tohmatsu Limited, e cila është një shoqëri private britanike e kufizur nga garancitë. Secila nga këto shoqëri përfaqëson një entitet ligjor të ndarë dhe të pavarur. Përshkrim i detajuar i struktures ligjore të shoqërisë Deloitte Touche Tohmatsu Limited dhe shoqërive të saj anëtare e gjeni në adresen www.deloitte.com/al/about

Deloitte ofron shërbime në fushat e auditimit, taksës, konsulences dhe këshillimit financiar, në të gjitha industritë, shoqërive si private ashtu dhe atyre publike. Me një rrjet global shoqërishtë anëtare, në më shumë se 150 shtete, Deloitte sjell aftësi me nivel botëror dhe shërbime me cilësi të lartë për klientët e saj, duke i dhënë bizneseve njohuritë që i nevojiten për të adresuar sfidat me komplekse që ato hasin. Pothuajse 245,000 profesionistët e Deloitte janë të angazhuar për t'u bërë standardi i përsosmërisë.